



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:219612
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06538973

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Burhan Berisha, me zyrtaren ligjore Blerina Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. B. nga Komuna e Kaçanikut, i përfaqësuar me autorizim nga Zyra Ligjore "...", kundër te paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine lidhur me çështjen juridiko-kontestimore kompensim demi, duke vendosur sipas parashtrësës se paditësit te datës 27.11.2024, jashtë seance gjyqësore me datën 03.12.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e TËRHEQUR padia e paditësit I. B. nga Komuna e Kaçanikut, i përfaqësuar me autorizim nga Zyra Ligjore "...", e ushtruar ne kete gjykate me datën 08.08.2024, kundër te paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine lidhur me çështjen juridiko-kontestimore kompensim demi.
- II. DETYROHET pala paditëse qe te paguaj taksen gjyqësore për padi ne shume prej 20€, brenda afatit prej 15 ditësh me rastin e pranimit te këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes te autorizuarit te tij, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 08.08.2024, kundër te paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine lidhur me çështjen juridiko-kontestimore kompensim demi.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së dt. 27.11.2024 e ka njoftuar gjykatën

se në këtë çështje juridike kontestuese paditësi me të paditurën çështjen kontestuese e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore me marrëveshje. Ku ne këtë parashtrese për tërheqjen e padisë e ka bashkëngjitur edhe marrëveshjen jashtëgjyqësore të lidhur në Prishtinë me datën 15.11.2024, në mes të palëve ndërgjyqës për kompensimin e dimit të aksidentit të trafikut të datës 08.11.2023. .

Gjykata vendosi që të pranojë të tërhequr padinë e paditësit në kuptim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës kontestimore, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e morri konform nenit 12.1 të UA, të KGJK-së nr. 01/2017 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe e detyroi palën paditëse që të paguaj shumën prej 20€ në emër të taksës për padi pasi që i njëjti nuk e ka paguar taksën gjyqësore me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë.

Nga se u theksua me lart u vendos konform dispozitave juridike të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-
Dega Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2024:219613, dt. 03.12.2024

Gjyqtari:
Burhan BERISHA

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa